

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draftaktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/2014 ‘Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare’, i ndryshuar”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) janë zhvilluar për një periudhë prej 20 ditësh pune, nga data 19.05.2026 deri më 16.06.2026, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Projektligji synon përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe përmbushjes së detyrimeve të Kapitullit 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”.

Konsultimi publik është realizuar përmes publikimit të projektligjit në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” (RENJKP), për periudhën 19.05.2026 – 16.06.2026. Në zbatim të ligjit nr. 146/2014, janë ftuar qytetarët, ekspertët e fushës, organizatat e biznesit, shoqatat profesionale dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar gjatë procesit të konsultimit publik.

Në portal janë publikuar projektligji, relacioni shoqërues, dokumenti konsultativ dhe Draft-RIA, duke mundësuar njohjen e plotë të palëve të interesit me objektivat dhe përmbajtjen e projektaktit.

Projektligji synon përmirësimin e kuadrit ligjor për pagesat e vonuara në transaksionet tregtare, harmonizimin e afateve të pagesës sipas standardeve evropiane, forcimin e mekanizmave të kamatëvonesave, zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit dhe rritjen e sigurisë juridike për sipërmarrjet. Ndryshimet adresojnë problematikat që lidhen me vonesat në pagesa, të cilat ndikojnë në likuiditetin dhe konkurrueshmërinë e bizneseve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Gjatë periudhës së konsultimit publik nuk janë paraqitur komente apo sugjerime nëpërmjet portalit RENJKP. Megjithatë, gjatë procesit të konsultimit janë marrë komente dhe sugjerime nga institucione dhe organizata të interesuara, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar në masën e përshtatshme në projektligj.

4. Palët e interesit të përfshira

930 vizitorë kanë lexuar projektligjin nëpërmjet RENJKP.

Palët e interesit të përfshira në procesin e konsultimit kanë qenë qytetarë, ekspertë të fushës, organizata të biznesit, shoqata profesionale dhe përfaqësues të tjerë të publikut. Gjithashtu, gjatë procesit të konsultimit janë paraqitur komente dhe sugjerime nga Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar (<i>psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.</i>)	Komenti (<i>grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku</i>)	Palët e interesuara (<i>renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme</i>)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Përkufizimi i termit "Sipërmarrje"	U propozua zgjerimi i përkufizimit të termit "sipërmarrje", duke përfshirë edhe personin fizik që ushtron veprimtari ekonomike ose profesionale, me qëllim shmangien e problematikave të evidentuara në praktikën gjyqësore lidhur me llogaritjen e kamatëvonesës.	Shoqata Shqiptare e Bankave	I pranuar	Komenti u reflektua në tekstin e projektligjit, duke harmonizuar përkufizimin me Direktivën 2011/7/BE dhe sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë.
Fusha e zbatimit të ligjit	U propozua që ligji të trajtojë edhe individët përfitues të kredive konsumatore dhe hipotekore ose, alternativisht, të rishikohet legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit apo të hartohet një kuadër i posaçëm ligjor për të drejtën e detyrimeve.	Shoqata Shqiptare e Bankave; Dhoma Kombëtare e Noterëve; Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë	I refuzuar	Projektligji rregullon vetëm pagesat e vonuara në transaksionet tregtare. Rregullimi i marrëdhënieve me konsumatorët nuk është objekt i kësaj nisme ligjore dhe kërkon ndërhyrje në legjislacion tjetër.

<p>Normat referuese të interesit</p>	<p>U propozuan ndryshime në përkufizimin e normës referuese të interesit për lekun, euron dhe monedhat e huaja, harmonizimi i terminologjisë me aktet e Bankës së Shqipërisë, si dhe qartësimi i metodologjisë së zbatimit dhe i rendit të përdorimit të normave referuese.</p>	<p>Banka e Shqipërisë; Shoqata Shqiptare e Bankave; Dhoma Kombëtare e Noterëve; Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Komentet teknike u morën në konsideratë dhe u reflektuan në projektligj, duke riformuluar dispozitat për normat referuese në përputhje me Direktivën 2011/7/BE dhe terminologjinë e përdorur nga Banka e Shqipërisë.</p>
<p>Afati për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit</p>	<p>U kërkua harmonizimi i afatit 90-ditor për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit me Kodin e Procedurës Civile, duke argumentuar se parashikimi i afateve procedurale në një ligj të posaçëm mund të krijojë vështirësi në praktikë.</p>	<p>Banka e Shqipërisë; Shoqata Shqiptare e Bankave; Dhoma Kombëtare e Noterëve; Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë</p>	<p>I pranuar pjesërisht</p>	<p>Komenti u vlerësua. Megjithatë, dispozita u ruajt për shkak të nevojës për përafrimin e plotë me nenin 10 të Direktivës 2011/7/BE, e cila parashikon afatin maksimal prej 90 ditësh kalendarike. Në vijim të sugjerimit të Ministrisë së Drejtësisë, u vlerësua se ky përafrim do të sigurohet nëpërmjet miratimit të projektligjit me shumicën e cilësuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës.</p>
<p>Harmonizimi i projektligjit me legjislacionin në fuqi</p>	<p>Gjatë konsultimeve u theksua nevoja për harmonizimin e projektligjit me legjislacionin procedural dhe kuadrin ekzistues, me qëllim garantimin e një zbatimi efektiv dhe të unifikuar të dispozitave të tij.</p>	<p>Banka e Shqipërisë; Shoqata Shqiptare e Bankave; Dhoma Kombëtare e Noterëve; Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë</p>	<p>I pranuar pjesërisht</p>	<p>Komentet teknike të paraqitura gjatë procesit të konsultimit u shqyrtuan dhe u reflektuan në masën që ishin në përputhje me objektin e projektligjit dhe kërkesat e Direktivës 2011/7/BE.</p>